REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 336120
Data/Datum 15.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues – Visar Bibaj Eksperti teknik - Živče Šarkoćević	*Data e autorizimit të ekspertit* *03.06.2020.*	*Data e dorëzimit të raportit* *13.06.2020.*	Nr. i lëndës: 336/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.05.2020. OE N.T.SH. "EKOINVEST" – Prishtinë, ka parashtruar ankesën me nr.: 336/20, kundër njoftimit për eliminim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas", me nr.: KEK-19-250-111, Numri i brendshëm: KEKO-19-055-111, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AU) – "Korporata Energjetike e Kosovës" - Prishtinë.

Autoriteti zhvilloi një procedurë të hapur të prokurimit: **"Furnizim me makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas"**, me nr.: **KEK-19-250-111**, Numri i brendshëm: **KEKO-19-055-111**. Tenderi është publikuar në **KRPP** me datën **04.02.2019**. nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës, procedurë e hapur. Afati për parashtrimin e tenderit ka qenë data **18.03.2019.**, si dhe hapja e tenderëve ka qenë me **18.03.2019.** Vlera e parashikuar e kontratës: **450.000,00 €.**
Në bazë të nenit 113, 114 të Ligjit me nr. 04 / L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04 / L-237, Ligjin 05 / L-068 dhe Ligjin 05 / L-092, eksperti për rivlerësim e ka shqyrtuar ankesën e OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1, 6, 59 dhe 62 te LPP-se si dhe neni 41.2, te RRUOPP-se.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP,

Me datën 08.05.2020 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar Letrën Standarde për Ne ANEKS I te DT ,pil<a 1.2.7- eshte kërkuar: Pneumatic Dot-Peen Pin Stamp Marker Station, ndërsa ne ofertën e juaj ju e keni dhënë katalogun me përshkrirn teknik te Optinal Dot-Pen Marker te prodhuesit Mannesman Modeii ES 350 ER.

-Te prerja me plazme janë kërku për çeliçet e buta mundesija e prerjes prej 0,5 - 80mm; për çeliçe austentike 3 - 80mm dhc për metale me ngjyrë 6-80mm ndersa sipas katalogut te prodhuesit eshte ofru vetem maksimumi i prerjes dmth. 80mm.

-Askund ne katalogun e prodhuesit nuk figurojnë standardet e kërkuara: DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100 te cilat standarde janë esenciale për këte lloji te paisjes.

- Nga prodhuesi nuk eshte cek se a garantohet lidhur me celikun e konstrukcionit per pune te rënda me ngarkesë si kërkohet ne dosje te tenderit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtus – Visar Bibaj Eksperti teknik - Živče Šarkoćević	*Data e autorizimit të ekspertit 03.06.2020.*	*Data e dorëzimit të raportit 13.06.2020.*	Nr. i lëndës: 336/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.05.2020. OE N.T.SH. "EKOINVEST" – Prishtinë, ka parashtruar ankesën me nr.: 336/20, kundër njoftimit për eliminim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas", me nr.: KEK-19-250-111, Numri i brendshëm: KEKO-19-055-111, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AU) – "Korporata Energjetike e Kosovës" - Prishtinë.

Autoriteti zhvilloi një procedurë të hapur të prokurimit: **"Furnizim me makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas"**, me nr.: **KEK-19-250-111**, Numri i brendshëm: **KEKO-19-055-111**. Tenderi është publikuar në **KRPP** me datën **04.02.2019**. nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës, procedurë e hapur. Afati për parashtrimin e tenderit ka qenë data **18.03.2019.**, si dhe hapja e tenderëve ka qenë me **18.03.2019.** Vlera e parashikuar e kontratës: **450.000,00 €.**
Në bazë të nenit 113, 114 të Ligjit me nr. 04 / L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04 / L-237, Ligjin 05 / L-068 dhe Ligjin 05 / L-092, eksperti për rivlerësim e ka shqyrtuar ankesën e OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1, 6, 59 dhe 62 te LPP-se si dhe neni 41.2, te RRUOPP-se.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP,

Me datën 08.05.2020 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar Letrën Standarde për Ne ANEKS 1 te DT ,pil<a 1.2.7- eshte kërkuar: Pneumatic Dot-Peen Pin Stamp Marker Station, ndërsa ne ofertën e juaj ju e keni dhënë katalogun me përshkrirn teknik te Optinal Dot-Pen Marker te prodhuesit Mannesman Modeii ES 350 ER.

-Te prerja me plazme janë kërku për çeliçet e buta mundesija e prerjes prej 0,5 - 80mm; për çeliçe austentike 3 - 80mm dhc për mctale me ngjyrë 6-80mm ndersa sipas katalogut te prodhuesit eshte ofru vetem maksimumi i prerjes dmth. 80mm.

-Askund ne katalogun e prodhuesit nuk figurojnë standardet e kërkuara: DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100 te cilat standarde janë esenciale për këte lloji te paisjes.

- Nga prodhuesi nuk eshte cek se a garantohet lidhur me celikun e konstrukcionit per pune te rënda me ngarkesë si kërkohet ne dosje te tenderit.

- Ne specifikimin teknik te detyrushëm është kërku që prodhuesi dimenzionet e paisjes i adapton ne bazë të dhënave bazike e këtë perms katalogut nuk mund ta shofim sakt. Kjo nenkupton qe pasi qe behet fjale per nje paisje e cila nuk eshte prodhim serik por punohet sipas porosise si dhe eshte shume e shtrejt prodhuesi ose ofertuesi eshte I obliguar qe perveq katalogut te prodhimeve serike te siguroj nje skice ose vizatim tre dimensional ku ne baze te kerkeses se ofertes paraqiten paisja me repartet percjellese ku seicili repart eshte dasht te shenohet ne baze te dosjes se tenderit. Kete po e cekim pasi cdo prodhues serioz qe prodhon paisje sipas porosise ta ofron skicen trdimenzlonale si do te duket paisja e porositur me te gjitha te dhenat kjo njiherit eshte edhe garancion se do ta punoj ate qe eshte kerkuar.

- **Katalogu i prodhusit i ofruar është një katalog i pakompletuar ne tërsi, nuk është bërë renditja dhe nenvizimi (është i pjeserishëm) i karakteristikave teknike sipas dosjës se tenderit.** Katalog të pajisjeve me të cilën kemi ofertuar të vërtetuara nga prodhuesi **LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S** , ashtu siç ka kërkuar edhe Autoriteti Kontraktues në nenin 9.1 &9.2 ne FDT të dosjes se tenderit. Ne katalogun që kemi dorëzuar së bashku me ofertën është edhe katalogu dhe përshkrimi teknik ku është i përcaktuar edhe modeli i **Markerit Dot-Peen Modeli ES 350 ER.** Ne se bashku me ofertën kemi dorëzuar edhe Aneksin nr. 1 Specifikat Teknike të detyrueshme te Dosjes se Tenderit e kemi nënshkruar dhe vulosura nga lideri i grupit te OE NTSH "EKOINVEST" dhe Prodhuesit **LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S** dhe Deklaratën e Përputhshmërisë se Specifikave Teknike te nenskruar dhe vulosur nga lideri i Grupit te OE, që dëshmon qe Makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas me të cilën ne kemi ofertuar është konforme specifikave teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Aneksit nr. 1 të Dosjes se Tenderit; **Dëshmia 1. Se Markeri Dot-Peen Modeli ES 350 ER dhe pajisja në tërësi i plotëson të gjitha specifikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në vendimin PSH. nr. 61/20 i datës 26.02.2020;**

- **Konstatimi i Autoritetit Kontraktues se në katalog është ofruar vetëm maksimumi i prerjes prej 80 mm nuk munde të jete arsyeje për eliminim të ofertës për faktin së për çdo njërin që ka njohuri elementare të kësaj pajisje , kur është shënuar maksimumi prej 80 mm nënkuptohet se koka e CNC ka kapacitet prerje prej 0 mm deri 80mm.**

- **Ne asnjë vend të Dosjes se Tenderit Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar që në katalogun e prodhuesit të shënohen Standardet DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100. Bazuar në kërkesën e AK të paraqitur ne Aneksin nr. 1 te Dosjes se tenderit në së bashku meofertën kemi dorëzuar Deklarate të nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi së Makina Portale CNC do të jete e prodhuar sipas standardeve DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100: Dëshmia 2**

© **Bazuar në dhënat e shënuara në Dosje te Tenderit, dimensionet e pajisjes janë në diskrecion të prodhuesit. Autoritetit Kontraktues vete e ka cekur se kemi të bëjmë me pajisje specifike e cila nuk është prodhim serik por prodhohet sipas porosisë dhe është shume e shtrenjte, prandaj nuk mund të jete arsyeje e eliminirnit mos paraqitja e skicave apo vizatimit tredimensional të pajisjes gjate fazës se ofertimit pasi qe një kërkese e tille nuk ka qene e shënuar në Dosje te Tenderit dhe kur dihet se një pajisje e tille ende nuk është prodhuar por pritet të prodhohet sipas kërkesave të AK. Ne se bashku me ofertën kemi dorëzuar Deklarata**

me shkrim te nënshkruar dhe vulosur nga Prodhuesi LOY MAK Makine , (qe është edhe anëtar i konsorciumit) dhe Lideri i konsorciumit NTSH Ekoinvest së dimensionet kryesore të makinës do te zgjidhen nga prodhuesi dhe do të adaptohen në baze të të dhënave bazike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Dëshmia 3. Nëse vjen deri të nënshkrimi i kontratës ne do te bashkëpunojmë ngushte me AK gjate tere procesit të prodhimit të pajisjes dhe do të konsultohemi paraprakisht për çdo detaj duke përfshi edhe dimensionet e pajisjes

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit. 3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e certifikatës TVSH-se; 3. Kopja e certifikatës numrit fiscal

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

NA

Dëshmia e kërkuar dokumentare

NA

Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentuese
2. Çertifikate te produktit ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet 3. Katalogje te produkteve
4. Një listë te referencave qe dëshmohen furnizimet e natyrës se ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Autorizim nga kompania prodhuesi i cili e finalizon projektin
2. Certifikatë Standard ISO 9001 2015 të prodhuesit për produktet e ofruara
3. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatim te vërtetuar nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog

pjese te katalogut dhe apo vizatim sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.
4. Operatori ekonomik prodhuesi duhet te prezantoj një liste përmes se cilës dështmohen furnizimet të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate, duke saktësuar produktet e liferuara, shumën e kontratës dhe datën e pranimit nga konsumatori i fundit; duke ja bashkangjitur se paku 1 (një) reference apo çertifikate te pranimit te furnizimeve nga konsumatori i fundit

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

AP duhet te anulohet ne mungese te ofertave te pergjegjeshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

NA

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

NA

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(NA).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ND" SH.P.K. – Prishtinë

Në Letrën Standarde për Ofertuesin e Eliminuar qëndron:

1. Në Aneksin 1 të DT, pika 1.2.7 – është kërkuar: Pneumatic Dot-Peen Pin Marker Station, ndërsa ju në ofertën e juaj keni ofruar katalogun me përshkrim teknik nga ana e Optinal Dot-Pen Marker nga prodhuesi Mannesman Model ES 350 ER.
2. Te prerja me plazmë janë kërkuar për çeliqet e buta mundësia e prerjes prej 0,5 – 80 mm; për çeliqe austentike 3-80 mm, dhe për metale me ngjyrë 6-80 mm, ndërsa sipas katalogut të prodhuesit është ofru vetëm maksimumi i prerjes, dmth. 80mm.
3. Askund në katalogun e prodhuesit nuk figurojnë standardet e kërkuara: DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206, dhe DIN EN ISO 12100, të cilat standard janë esenciale për këtë lloj të pajisjes.
4. Nga prodhuesi nuk është cek se a garantohet lidhur me çelikun e konstruksionit për punë të rënda me ngarkesë si kërkohet në dosje të tenderit.

5. Në specifikimin teknik të detyrueshëm është kërkuar që prodhuesi dimensionet e pajisjes i adapton në bazë të dhënave bazike e këtë përmes katalogut nuk mund ta shohim saktë. Kjo nënkupton që pasi që bëhet fjalë për një pajisje e cila nuk është prodhim serik por punohet sipas porosisë si dhe është shumë e shtrenjtë prodhuesi ose ofruesi është i obliguar që përveç katalogut të prodhimeve serike të siguroj një skicë ose vizatim tre dimensional ku në bazë të kërkesës se ofertës paraqiten pajisje me repartet përcjellëse ku secili repart është dashtë të shënohet në bazë të dosjes së tenderit. Këtë po e cekim pasi çdo prodhues serioz që prodhon pajisje sipas porosisë ta ofron skicën tre dimensionale si do të duket pajisja e porositur me të gjitha të dhënat kjo njëherit është edhe garancinë se do ta punoj atë që është kërkuar.
6. Katalogu i prodhuesit i ofruar është një katalog i pakompletuar në tërësi, nuk është bërë renditja dhe nënvizimi (është i pjesërishëm) i karakteristikave teknike sipas dosjes së tenderit.

Me analizimin e arsyeve të lartë cekura të eliminimit i paraqes faktet e radhës sipas pikave të paraqitura edhe në Letrën Standarde për Ofertuesin e Eliminuar:

Pika 1.

Unë qëndroj plotësisht mbrapa deklaratës së dhënë në ekspertizën me nr. 61/20:

Makina portale CNC për prerje me plazmë dhe gas të ofruar nga OE NTSH "EKOINVEST,, si udhëheqës i konsorciumit dhe prodhuesi LOY-MAK SAN VE TIC A.S është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit. Da Markeri Dot-Peen Model ES 350 ER dhe pajisjet e plotësojnë plotësisht të gjitha specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Pika 2.

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues që në katalog është ofruar vetëm trashësia maksimale e prerjes prej 80 mm. Teknikisht është e qartë se një makinë që mund ta bëjë prerjen e materialeve me trashësi 80 mm sigurt makina e cekur CNC mund ti prej edhe materiale më të holla me zgjedhjen e disa parametrave të prerjes për çeliqet e zakonshëm ose austenitikë ose metale me ngjyra.

Pika 3.

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues deklaron "Prodhuesi duhet të dëshmojë se i plotëson standardet e cilësisë: DIN EN ISO 9013, DIN EN 28206, DIN EN ISO 12100. Megjithatë, nuk thuhet askund se Standardet duhet të futen në katalogun e prodhuesit. Këto standarde të cekura i referohen:

- DIN EN ISO 9013 (Ky dokument paraqet specifikimet gjeometrike të produktit dhe tolerancë së cilësisë për klasifikimin e prerjeve termike në materialet e përshtatshme për prerjen me zjarr me karburant oksigjeni, plazmë dhe laser. Është i zbatueshëm për prerjet me zjarr nga 3 mm deri 300 mm, prerjet me plazmë nga 0,5 mm deri 150 mm, dhe prerje me laser prej 0,5 mm deri 32 mm).
- DIN EN 28206 (Testimi i pranimit të makinave për prerje me të oksigjenit, testimit të lëngjeve dhe karakteristikave të punës (ISO 8206: 1991); version gjerman EN 28206: 1992)
- DIN EN ISO 12100 (SIGURIA E MAKINERIVE – PARIMET E PËRGJITHSHME TË DIZAJNIT – VLERËSIMI I RREZIKUT DHE REDUKTIMI I RREZIKUT)

OE NTSH "EKOINVEST„ ka paraqitur një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur nga ana e prodhuesit "LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S" që makina e kërkuar Portalna CNC do të prodhohet në përputhje me standardet: DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206, i DIN EN ISO 12100.

Pika 4.

Makina në fjalë paraqet pajisje specifike që nuk është një nga produktet serike por është bërë për tu porositur. Dimensionet dhe karakteristikat teknike të kërkuara me DT paraqesin bazën për hartimin e makinës së kërkuar, e cila duhet të prodhohet në përputhje me kërkesat e AK-së. OE NTSH "EKOINVEST„ së bashku me prodhuesin "LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S" ka dorëzuar një deklaratën e nënshkruar dhe të vulosur që dimensionet e makinës të definuar në DT do të respektohen. Gjithashtu, në DT nuk thuhet se OE janë të detyruar të paraqesin skica tre dimensionale në fazën e dorëzimit të ofertave, të cilat do të tregojnë pamjen e tërë makinerisë dhe disa prej pjesëve të saj. Dokumentacioni i plotë teknik së bashku me udhëzimet për trajtimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve rezervë dorëzohen me liferimin e pajisjeve-makinerisë. Përgatitja e dokumentacionit të përmendur në fazën e paraqitjes së ofertave do të kërkonte burime të konsiderueshme financiare, sepse është në pyetje projektimi i pajisjeve të veçanta dhe jo produkti cili është në prodhim serik.

Pika 5.

Qëndroj plotësisht pranë konstatimeve të dhëna në Ekspertizën me nr. 61/20. Katalogu i prodhuesit të cilin e ka ofruar OE së bashku me ofertën i përmbush kërkesat e DT sepse tregon që prodhuesi "LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S" prodhon tipin e kërkuar të makinerisë. Duke marrë parasysh që kemi të bëjmë me një makineri e cila është specifike, dhe e cila siç e kemi theksuar, prodhohet sipas porosis, është jo reale që të pritet që katalogu i ofruar të përmbajë detajet e pajisjes e cila instalohet në makinerinë e kërkuar.

Në bazë të të gjithave me lartë të cekura makineria portale CNC e ofruar nga ana e OE ankues i përmbush të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të paraqitura ne dosjen e tenderit – Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES/ TEKNIK

Në bazë të sqarimeve më lartë të cekura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE OE N.T.SH. "EKOINVEST" – Prishtina, të aprovohet si e bazuar, dhe lënda te kthehet ne RI VLERESIM.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS .Sh.a..
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – OE N.T.SH. "EKOINVEST"